



**UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

MASTER SHKENCOR

TEMA

Ndikimi i fenomenit burnout te personeli infermieror i pediatriisë

**Paraqitur në kërkim të Diplomës
Master Shkencor**

NGA

Irma Vogli

Udhëhequr nga PHD. Ela Peto

Vlorë, 2019

FALENDERIME

Ky punim do të ishte i pamundur të realizohej pa ndihmën e personave që më mbështetën në këtë rrugëtim të vështirë.

Falenderimi i parë shkon për udhëheqësen time shkencore Dr.Ela Peto, për mbështetjen e jashtëzakonshme për përfundimin e kësaj teme diplome.

Falënderimi i dytë shkon për profesorët që më kanë mbështetur dhe që më kanë dhënë mësim .

Falenderime dhe mirënjohje shkojnë veçanërisht edhe për të gjithë infermierët të cilët u bënë pjesë e këtij studimi dhe që përballen çdo ditë me raste dhe sfida në punën e tyre.

Veçanërisht ,falenderime të pakufijshme për familjen time që më mbështetin dhe më inkurajojnë me durim në çdo hap ,duke i dhënë kuptim sakrificave të mia e duke bërë që munda im të mos shkojë asnjëherë dëm.

ABSTRAKTI

Hyrje: Ndryshimet e ndodhura në shoqëri dhe transformimet në punë kanë rrit interesin për të studiuar fenomenin burnout. Komuniteti i infermierëve është i lidhur me stresin dhe burnoutin dhe kjo sjell ndikime te individi dhe organizata. Këto ndikime mund të jenë ekonomike por gjithashtu mund të ndikojnë negativisht edhe në cilësinë e kujdesit ndaj pacientit.

Qëllimi : Qëllimi i këtij studimi është të evidentohen perceptimet e personelit infermieror në lidhje me nivelet e përjetimit të burnoutit.

Metodologjia : Pas një shqyrtimi të hollësishëm të literaturës bashkohore, për mbledhjen e të dhënave u përdoren metoda të karakterit sasior. Në metodologjinë sasiore perceptimet e profesionistëve mbi burnoutin janë matur me anë të Inventarit të Burnoutit të Maslach (MBI).

Gjithsej në këtë studim morën pjesë 53 infermierë, ku përkatësisht 60.4% e tyre u përzgjedhën në repartin e pediatriisë dhe 39.6% nga nëntë qendra shëndetsore.

Të dhënat u analizuan sipas paketës statistikore SPSS 22.

Rezultate:Gjetjet e përftuara nga analiza deskriptive treguan për disa faktorë si statusi civil, eksperiencia në punë, niveli i edukimit që ndikojnë në nivelin e burnoutit te infermierët.

Vlera e koeficientit të korrelacionit ($r = -0,818$) na tregoi se sa më të lodhur emocionalisht të ndihen infermierët aq më të pakta do të jenë arritjet në punën e tyre.

Gjithashtu nëpërmjet analizës statistikore T-test ($p = 0.024$) u identifikua se mes dy grupeve ka ndryshime statistikisht të rëndësishme gjë e cila na çon në konkluzionin se infermierët në repartin e pediatriisë përjetojnë një nivel më të lartë të burnoutit në krahasim me infermierët që punojnë në qendra shëndetsore.

Ky studim ka një rëndësi të madhe për të parandaluar fenomenin e burnoutit te personeli i kujdesit shëndetsor .

Fjalët kyç: *infermier, burnout, reparti i pediatriisë*

ABSTRACT

Introduction : In the light of social change and a transformation in the work situation, interest in the problem of burnout has grown over the past decade. Community nursing is associated with stress and burnout, which can impact heavily on the individuals and organizations. These impacts can be both economically and also the negatives effects on the quality of patient care.

Aim: The purpose of this study is to identify the perceptions of the nursing staff regarding the levels of burnout experience.

Methodology :After a detailed review of contemporary literature, quantitative methods were used for data collection.

In the quantitative methodology, professionals' perceptions of burnout were measured using the Maslach Burnout Inventory (MBI).

A total of 53 nurses participated in this study, with 60.4% of them being selected in the pediatric ward and 39.6% from nine health centers.

The data was analyzed using SPSS 22 version.

Results:The findings obtained from descriptive analysis indicated several factors such as civil status, work experience, level of education affecting burnout level among nurses.

The correlation coefficient value ($r = -0,818$) showed that the more emotionally tired the nurses felt, the less efficient their work is.

Also, statistical analysis T-test ($p = 0.024$) identified that there was a statistically significant difference between the two groups which leads us to the conclusion that the nurses in the pediatric ward have a higher level of burnout compared to the working nurses. in health centers.

This study is of great importance in preventing the phenomenon of burnout among healthcare personnel.

Keywords: nurse, burnout, pediatric ward

Leje etike e studimit

Kërkesë

Drejtuar: Spitalit Rajonal Vlorë

Unë, e nënshkruara Irma Vogli, studente në Fakultetin e Shëndetit Publik në degën Infermieri e Përgjithshme, në universitetin e Vlorës "Ismail Qemali "kërkoj lejen tuaj si institucion për të realizuar studimin tim në repartin e pediatriisë.

Qëllimi i këtij studimi është të evidentohen perceptimet e personelit infermieror në lidhje me nivelet e përjetimit të burnoutit.

Perceptimet e profesionistëve mbi burnoutin do të maten me anë të Inventarit të Burnoutit të Maslach (MBI).

Ju ritheksoj se të dhënat do të përdoren thjesht për qëlime studimi dhe se do të ruhet anonimati.

Me konsideratë!

Irma Vogli

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	6
2.Shqyrtimi i literaturës	8
2.1 Historiku i burnoutit	8
2.2 Faktorët që ndikojnë në sindromën burnout	8
2.3 Ndikimi i burnoutit në personelin infermieror.....	11
2.4 Infermierët në repartin e pediatriisë	14
2.5 Fuqizimi i prindërve për përballimin e stresit.....	17
3.Metodologjia	20
3.1 Prezantimi i studimit	20
3.2Kampionimi	20
3.3 Instrumenti	21
3.4 Analiza e të dhënave	22
3.5 Limitet e Studimit	23
4. Rezultatet	24
5.Diskutime.....	59
6.Konkluzione.....	62
7.Rekomandime dhe sugjerime.....	63
8. Bibliografia	64
9.Shtojca.....	67

Hyrje

Sindroma Burnout , një sëmundje e shoqërisë moderne?

Jam tepër i stresuar, sa duket sikur gjithçka po merr fund,... Dua të heq dorë nga puna ime ,... Bateria ime po mbaron ...

Më duket sikur po më merret fryma sa nuk duroj dot njeri..

Kush nuk i ka dëgjuar shprehje të tilla veçanërisht kur njerëzit janë duke folur në lidhje me punën e tyre?

Por a tregojnë këto deklaratat thjesht mungesë performance dhe justifikime apo janë simptoma të një sëmundjeje që mund të përkufizohet me termin Sindromi Burnout?

Termi " burnout" u përdor për herë të parë nga psikanalisti Freudenberg, i cili në një nga botimet e tij e përkufizoi si problem jo vetëm fizik por edhe psikologjik që ndjek një cikël të caktuar. [1]

Vite më vonë Maslach e përmirësoi këtë përkufizim duke e konsideruar një sindromë që karakterizohet nga rraskapitje emocionale, depersonalizim dhe arritje të ulta personale.

Madje Maslach për të matur nivelin e burnout prezantoi dhe një instrument të quajtur Maslach Burnout Inventory (MBI) i cili përdoret gjerësisht edhe në ditët e sotme. [2]

Burnout shfaqet tek individët që punojnë në profesione që kërkojnë një shkallë të lartë ndërveprimi me të tjerët .

Prandaj sipas hulumtimeve të ndryshme të studiuarit e burnout në fushën e infermierisë specifikisht te infermierët që punojnë në pediatri përbën një problem me interes publik veçanërisht për ato vende që janë të industrializuara. [2]

Puna e drejtpërdrejtë me fëmijët që marrin shërbime të kujdesit shëndetësor i ekspozon në mënyrë të përsëritur infermierët e pediatri ndaj dhimbjes dhe vuajtjes duke u shndërruar në një burim potencial i stresit.

Kujdesi për pacientët e vegjel në mjediset e spitalit mund të përbëjë një sfidë të vërtetë, pasi sëmundja mund të shkatërrojë cilësinë e jetës së fëmijëve të sëmurë dhe familjeve të tyre .

Por gjithashtu kjo sëmundje mund të ketë një ndikim shkatërrues edhe në jetën e infermierëve.[2]

Sipas Stam (2010) ata fillojnë të ndihen të lodhur, të irrituar, kërkojnë të shmangin kontaktet me të tjerët dhe fillojnë të bëjnë gabime në punën e tyre duke kërkuar edhe largimin . [3]

Nëse kjo gjendje emocionale, fizike vazhdon me të njëjtin intensitet atëherë infermierët kanë rënë" pre e burnout ".

Prandaj është e rëndësishme që gjithmonë të realizohen studime në mënyrë që:

- të evidentohen faktorët që ndikojnë në nivelin e burnoutit te infermierët .
- të krijohen strategji të parandalimit dhe të ndërhyrjes te infermierët e pediatriisë.

2. Shqyrtim Literature

2.1 Historiku i Burnout-it

Termi " burnout" është studiuar në dimensione të ndryshme prej vitit 1974 e deri në ditët e sotme duke u kthyer në një fenomen me një rëndësi të madhe globale. Shfaqja e këtij koncepti është e lidhur me disa zhvillime sociale,ekonomike dhe kulturore.

Së pari në fillim të viteve 1960 e më vonë, lufta kundër varfërisë në SHBA bëri që një numër i madh të rinjsh ti përkushtoheshin njerëzve duke iu ofruar shërbime të ndryshme për tu ardhur në ndihmë dhe për të plotësuar nevojat e tyre njerëzore. Megjithë përpjekjet që bënë për të zhdukur varfërinë për një dekadë ata e gjetën veten shumë të zhgënjyer duke përjetuar një nivel të lartë stresi dhe duke mos patur mundësi për tu trajtuar.

Së dyti një faktor tjetër ishte që shërbimet njerëzore iu nënshtruan gjithnjë e më shumë procedurave burokratike. Institucionet ku këta profesionistë punonin u bënë më të ngurta ndryshe nga më parë. Këto ndryshime në sistem sollën një përplasje mes vlerave personale njerëzore e atyre organizative.

Së treti revolucioni kulturor i viteve 1960 e dobësoi ndjeshëm autoritetin e profesionistëve si mjek, infermierë, mësues, oficer sigurie etj. Ata prisnin që të shpërbleheshin më shumë se në të kaluarën por nuk ndodhi ashtu.

- | |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none">A. Rezultat i stresit dhe mungesa e trajtimitB. Mospërshtatje mes mjedisit , shoqërisë dhe individitC. Mospërputhje mes pritshmërive dhe realitetit |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Këta janë tre faktorë specifikë që kanë dhënë një kontribut në shfaqjen e burnout-it në shekullin e XX-të.

Por një përkufizim më të qartë për këtë term e ka dhënë fillimisht Freudenberg " për t"iu referuar përdoruesve të drogave" . Ky term përshkruante gjëndjen fizike dhe psikologjike , ndjesitë e raskapitjes , zemërimit, arrogancës dhe fajit .

Sipas Freudenberg fjala burnout përshkruante një sindromë që përfshinte simptoma të raskapitjes , neglizhim të nevojave të vetes , të punuarit shumë gjatë dhe intensivisht si dhe të ndjerët nën presion nga stafi drejtues . [1]

Ndër profesionet që konsumoheshin më shumë përmendi : individët që punojnë në fushën e edukimit, psikologët, mjekët, infermierët punonjësit socialë, pra profesione të cilat kanë ndërveprime të shumta me njerëzit

Freudenberger thekson se konsumimi i "u ndodh punonjësve që e idealizojnë punën e tyre dhe që më pas e humbasin idealin.

Sipas Kraft (2006), psikologu Freudenberger dhe bashkëpunëtori i tij Gail North kanë siguruar ndarjen më të mirë të fazave të burnout të quajtur "Cikli i burnout" i cili përmban 12 faza. Këto faza jo vetëm që ndihmojnë në kuptimin më të mirë të këtij procesi, por gjithashtu ndihmojnë në diagnostikimin me kohë të këtij çrregullimi (Freudenberger & North n.d., cituar në Kraft 2006.). [4]

Është e rëndësishme të mbajmë mend se këto faza nuk duhet të ndjekin njëra-tjetrën sipas renditje të caktuar . Sipas Freudenberger dhe North, "shumë viktima kalojnë në faza të caktuara, të tjerët e gjejnë veten në disa të tjera në të njëjtën kohë".

Cikli i Burnoutit

- 1) Në fazën e parë të burnoutit , personi është i fiksuar të provojë veten e tij jo vetëm për vete , por edhe për të tjerët. Ambicia në këtë fazë konsiderohet në nivelin më të lartë Kjo mund të çojë në vendosmëri dhe detyrim por pacarësisht shoqërohen me ndjenja të pakënaqësisë.
- 2) Faza e dytë e burnoutit shpjegohet si një faze ku punohet shumë për të përmbushur pritshmëritë e larta personale. Në thelb në këtë fazë e vetmja arsye për të qenë punëtor janë këto pritshmëritë personale dhe të qenit i fiksuar pas trajtimit dhe kontrollit të gjithçkaje.
- 3) Në fazën e tretë të djegies, personi fillon të injorojë dhe të jetë indiferent në lidhje me nevojat e tij, përfshirë nevojat themelore siç janë gjumi dhe ngrënia. Ai nuk interesohet për asgjë përveç punës së tij dhe mendon se këto sakrifica e bëjnë atë një hero. Ndërveprimet shoqërore të personave reduktohen edhe me familjet dhe miqtë e afërt.[4]
- 4) Në këtë fazë, simptomat e para fizike të burnout do të shfaqen. Personi i prekur në këtë fazë është i vetëdijshëm për rritjen e nivelit të stresit dhe shqetësimin në jetën e tij, por nuk është në gjendje të njohë shkakun e tyre.
- 5) Në këtë fazë vlerat e personit të prekur do të rishikohen. Do të thotë që vlerat e mëparshme të personit, përfshirë nevojën themelore, marrëdhëniet me të tjerët dhe hobi, do të lihen pas dore dhe personi do të fillojë të vendos vlera të reja. Këto vlera të reja përmbledhen në punë dhe arritjet e saj. Këto ngjarje në kohë mund të bëjnë që personi të tejlohet emocionalisht.

- 6) Agresiviteti dhe negativiteti i personit në këtë fazë të burnout ndaj njerëzve që e rrethojnë dhe kolegëve të tij, do të rritet. Ky negativitet e bën atë të mendojë se kolegët e tij janë dembelë, budallenj dhe të padisiplinuar. Personi në këtë fazë fillon të fajësojë presionin e kohës dhe vëllimin e punës dhe jo ndryshimet e tij të sjelljes.
- 7) Kontaktet sociale të personit të prekur në këtë fazë të burnout do të jenë në nivelin e tij minimal. Ai thjesht në mënyrë obsesive bën punë. Të ndjerit i pashpresë dhe i pamotivuar në këtë fazë mund ta çojë personin e prekur drejt abuzimit të drogës dhe alkoolit.
- 8) Në këtë fazë, ndryshimet në sjellje do të jenë të qarta për njerëzit që kanë kontakt me viktimën dhe nuk mund t'i injorojnë më ato. Por personi ende i neglizhon ato. Për më tepër, të qenit indiferent, i frikësuar, i pavlerë dhe i trembur do të shtohet në tiparet e viktimës.
- 9) Personi në këtë fazë të burnout do të humbasë kontaktin me veten përveç humbjes së kontaktit me të tjerët. Asgjë nuk është e vlefshme për të. Ai nuk interesohet për nevojat e tij. Jeta do të konsiderohet si një proces mekanik. [4]
- 10) Në këtë fazë, personi ndjehet i zbrazur nga brenda dhe përpiqet të shpëtoj nga kjo ndjenjë duke kërkuar aktivitete të tilla si seksi, alkooli ose droga. Këto aktivitete shpesh ekzagjerohen. Koha e lirë konsiderohet si një kohë e vdekur për personin në këtë fazë të burnout.
- 11) Jeta nuk ka asnjë kuptim për personin në këtë fazë. Simptomat e depresionit do të shfaqen dhe personi ndjehet i humbur, i rraskapitur, i trishtuar, pa shpresë për të ardhmen dhe indiferent.
- 12) Kjo fazë është faza e fundit e cila emërtohet si sindroma e burnout . Të gjitha simptomat e lartpërmendura përfundimisht e çojnë personin në këtë fazë. Mendimet e vetëvrasjeve, kolapsi i plotë mendor dhe fizik janë shenjat e kësaj faze dhe kanë nevojë për kujdes të menjëhershëm mjekësor.

Ndërkohë që për Maslach dhe Jackson (1997) "burnout" është një sindromë që karakterizohet nga:

- rraskapitja emocionale

Rraskapitja emocionale i referohet një gjëndjeje të dërrmuar emocionale.

- Depersonalizimi

Depersonalizim do të thotë indiferencë e theksuar në rritje , një shkëputje ndaj njerëzve me të cilët punon.

- të ndjerët joefektiv në punë.

Të ndjerët jo efektiv në punë i referohet një rënie të nivelit të aftësive dhe produktivitetit si dhe një rënie të ndjenjës së vetëefikasitetit .

Kjo sindromë sipas Maslach shfaqet tek individët që punojnë në profesione që kërkojnë një shkallë të lartë ndërveprimi me të tjerët. [2]

De Caroli dhe Sagone (2014) në studimin e tyre të bazuar në përkufizimet e disa autorëve si Maslach, Cherniss, Schaufeli ,Ashforth dhe Bunk kanë arritur në një përmbledhje të konceptit të burnout.


Sipas tyre burnout është një lloj stresi ndërpersonal, një gjendje tensioni, një reagim , një pakënaqësi që zhvillohet kur njerëzit fillojnë të besojnë se nuk mund të ketë asnjë lloj zgjidhje pozitive për stresin që po përjetojnë. Është një gjendje e vazhdueshme negative mendore që shoqërohet me distres , rraskapitje emocionale , rënie të efektivitetit , rënie të motivimit , zhvillim të sjelljeve dhe qëndrimeve që janë jofunksionale. Karakterizohet nga bashkëzistenca e tre dimensioneve që janë :rraskapitja emocionale,depersonalizimi,dhe mungesa e ndjenjave të kompetencës dhe arritjeve në punë. Ai shkatërron shëndetin psikologjik dhe fizik., provokon sjellje negative , tërheqje dhe dorëheqje nga puna . Burnout është plotësisht e kundërta e një jete shpërblyese dhe kuptimplotë. [5]

Sipas Panagopoulos, Anastasiou dhe Goloni, burnout (konsumimi) është një reagim emocional negativ ndaj punës si pasojë e qëndrimit afatgjatë në mjedisin stresant të punës. Konsumimi është një variabël i rëndësishëm jo vetëm sepse është tregues i një mirëqënie të dobët por sepse lidhet me sjelljet , shëndetin dhe reagimet e punojësve. [6]

Megjithë zbulimet e shumta të reja në lidhje me zhvillimin të sindromës së burnout , shumë pyetje mbeten ende pa përgjigje. A është burnout thjesht nivel i lartë i stresit në vendin e punës apo një ndërveprim mes faktorëve të shoqërisë dhe atyre individual.

Padyshim ndryshimet në shoqëri, në punë, rritja e kërkesave, presioni ekonomik, punët jashtë orarit kanë çuar jo vetëm në një ndryshim të kërkesave por edhe në një rritje të padiskutueshme të nivelit të stresit. Prandaj pavarësisht përkufizimeve të ndryshme hulumtuesit bien dakord se niveli i lartë i stresit, zhgënjimet prej mosrealizimit të pritshmërive dhe zhytja në rutinën e përditshme janë çelsi për të kuptuar këtë fenomen.

2.2 Faktorët që ndikojnë në sindromën burnout [7]




Simptomat

Sipas studiuësve burnout është një process dinamik dhe simptomat e prekin pacientin në disa dimensione duke përfshirë: [7]

- ✓ gjendjen fizike
- ✓ psikologjike.

Në tabelën e mëposhtme këto simptoma do të jenë të paraqitura më konkretisht.



2.3 Ndikimi i burnoutit në personelin infermieror

Burnout është një sindromë që prek shumë punonjës veçanërisht ata, puna e të cilëve është e lidhur me njerëz sic janë personeli i kujdesit shëndetsor (Schaufeli, W, 2008). [8]

Burnout është studiuar dhe përshkruar si një çregullim psikologjik i shkaktuar nga mbingarkesa e vazhdueshme emocionale dhe fizike. Një infermier i cili vuan nga sindroma burnout ka rraskapitje emocionale, qëndrim negativ dhe cinik ndaj pacientëve, depersonalizim dhe mungesë aftësish për të realizuar me përpikmëri punën (Mackoniene, R., et al. 2012).

Këto simptoma kanë një ndikim negativ jo vetëm te infermieri i cili i përjeton po edhe te vetë spitali, pasi ulet cilësia e kujdesit që ai u ofron pacientëve. [9]

Sipas një hulumtimi të bërë nga Departamenti i Shëndetësisë në lidhje me mirëqënien fizike dhe psikologjike të infermierëve u arrit në përfundimin se sa më shumë të përmirësohet niveli i mirëqënies së infermierëve, aq më shumë do të rritet cilësia e kujdesit ndaj pacientëve.

Maslach dhe Jackson (1997) bënë kërkime për të zbuluar më shumë rreth këtij fenomeni dhe pasojave të tij. Sipas gjetjeve të tyre, cilësi më e ulët në kujdesin e ofruar ndaj pacientëve, puna me turne, rraskapitja fizike, çrregullimet e gjumit, abuzimet me alkoolin dhe ilaçet, si dhe problemet familjare mund të ndodhin si rezultat i burnout. [2]

Maslach dhe Jackson (1997) kanë krijuar gjithashtu një instrument të quajtur Maslach Burnout Inventory (MBI) në mënyrë që të matin ato tre aspekte të burnout midis stafit. Këto tre elemente ishin rraskapitja emocionale, depersonalizimi dhe mungesa e aftësive në punë. [2]

Në të njëjtat përfundime ka arritur edhe Abdo (2015). Sipas tij burnoti te personeli infermieror ndodhë si rezultat i një larmie arsyesh përfshirë, pabarazinë midis asaj që personi jep dhe merr në vendin e punës, çështje organizative, intensitetin emocional dhe fizik, stresin në vendin e punës, rraskapitjen, kushtet e papërshtatshme të punës fizike, oraret e punës që prishin marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, ambienti i pasigurt i punës, duke u ekspozuar ndaj problemeve psikologjike, socio-ekonomike dhe fizike të pacientëve, mungesa e burimeve, paga jo e përshtatshme, mungesa e sigurisë.[10]

Studiues të tjerë Fearon dhe Nicol (2011) pohojnë se fenomeni burnout shoqërohet me një sërë simptomash, pakënaqësi në punë, mungesa të shpeshta, joefektivitet në realizimin e detyrave, lodhje, nervozizëm konflikte, tendencë për çrregullime të shëndetit mendor si depresion, ankth e deri në braktisje të profesionit të infermierit. Kujdesi për punonjësit e shërbimit shëndetsor duhet të jetë një prioritet për të gjithë pasi mirëqënia e tyre ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e kujdesit që u ofrojnë pacientëve. [11]

Sipas Fearon dhe Nicol (2011) duhen ndërmarë një sërë masash dhe reformash organizative në mënyrë që të parandalohet burnout.

Saço (2015) e shpjegon burnoutin si një gjendje ku zhgënjimi në mjedisin e punës akumulohet dhe arrin deri në atë pikë ku individ nuk e kontrollon dot. Nga hulumtimet e tij ai arriti në përfundimin se më tepër rrezik për tu prekur nga burnout kanë infermierët që punojnë dhe kujdesen për pacientë që kanë kaluar traumë. [12]

Sipas Fennessey (2016) lodhja që ndiejnë infermierët në punë dhe mungesa e sigurisë ndikon jo vetëm në mirëqënien e tyre por edhe në qëllimin e tyre si infermier i cili është ti ofrosh një kujdes të sigurt dhe cilësor pacientit. Sipas tij kur infermieri është i tejloður dhe i mbingarkuar në punë rreziku për të gabuar ndaj pacientit është i lartë. [13]

Hinderer dhe të tjerë (2014) studioi infermierë të urgjencës, kujdesit intensiv, onkologjisë dhe pediatriisë dhe zbuluan se 82% e infermierëve kishin nivele të moderuara deri në nivele të larta të burnout gjë që tregon se sa i përhapur ky fenomen është. Ai vendosi të bëjë dhe një krahasim mes infermierëve që punonin në pavione të ndryshme dhe arriti në përfundim se ata infermierë që raportonin nivele më të larta të burnout i përkisnin pavionit të onkologjisë. Kjo mund të lidhej me faktin se në këtë pavion numri i rasteve të vdekjeve është i lartë. [14]

Hinderer (2014) gjithashtu zbuloi se infermierët të cilët kishin marrëdhënie konfliktuale me kolegët e tyre janë më të prirur për tu prekur nga burnout.

Në një studim të realizuar nga Michalec, Diefenbeck, dhe Mahoney (2013), u arrit në përfundim se infermierët e rinj pavarësisht se gjatë viteve të universitetit kishin raportuar një nivel të lartë kënaqësie për këtë profesion, gjatë viteve të punës kanë përjtuar një nivel të lartë të lodhjes dhe zhgënjimit [15]

Suping dhe Taliaferro (2015) realizuan një studim korrelacional duke studiuar lidhjen mes gjendjes psikologjike dhe lodhjes.

Ata arritën në përfundimin se ka një lidhje negative mes këtyre dy faktorëve. Sa më mire të jenë nga ana psikologjike infermierët aq më pak lodhje do të ndiejnë dhe do të kenë më tepër mekanizma për të përballuar sfidat e punës. [16]

Ndryshimet individuale luajnë një rol esencial. Hipoteza e organit të dobët në mjekësi, njohur gjithashtu dhe si fenomeni i thembrës së " Akilit" sugjeron se një person dorëzohet pikërisht në pikën e tij të dobët. Disa ndryshime individuale si për shembull gjinia, tipi i modelit A të sjelljes shkaktojnë dobësi në formë sforcimi në kushte stresante.

Potter (2010) përmes hulumtimeve dhe studimeve të ndryshme identifikoi disa faktorë të mundshëm që ndikojnë në prekjen e infermierëve nga burnout.

Sipas tij disa faktorë të zakonshëm janë numri i viteve në punë, mosha, mjedisi, aftësitë dhe strategjitë përballuese. Sipas zbulimeve të tij infermierët të cilët punonin në spital për një kohë të gjatë (për shembull për shumë se 11 vjet) kishin një rrezik më të lartë për tu prekur nga burnout. Edhe pse vitet e punës ishin një faktorë domethënës studimet treguan se mosha nuk ishte një faktorë përcaktues. [17]

Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte statusi civil, ku infermierët me statusin e të divorcuarve raportuan një nivel më të lartë burnouti.

Gjithashtu Saço dhe studiues të tjerë (2015) gjetën se infermierët të cilët kishin mbi 40 vjet përvojë në punë përjetonin nivele më të larta të burnoutit. Një gjetje tjetër e rëndësishme ishte se infermierët të cilët kishin një nivel më të lartë arsimor ishin më pak të rrezikuar. [12]

Ndërkohë që Berger (2015) gjeti se infermierët e rinj raportojnë nivel më të lartë të burnoutit. [18]

Për shkak të mospërputhjeve në këto studime, është akoma e paqartë nëse mosha është një faktor i rëndësishëm për të përcaktuar burnoutin.

Duke patur parasysh se numri i infermierëve në Jordani sa po vinte ishte gjithnjë në rënie pasi infermierët preferonin të largoheshin nga spitali dhe të emigronin si dhe duke qenë se ndjekja e studimeve për infermieri nuk ishte më një preference për studentët studiuesit vendosën të realizonin një studim.

Në këtë studim morën pjesë 407 infermierë të përzgjedhur në 11 spitale të ndryshme në Jordani. Infermierët që u bënë pjesë e këtij kampioni u përzgjedhën në pavione të ndryshme si në urgjencë, pediatri, maternitet. [19]

Mosha e infermierëve varioje nga 22- 53 vjeç dhe 57.25% prej tyre ishin femra.

Ky studim ishte i karakterit sasior dhe infermierët iu nënshtruan plotësisht të një pyetësori Maslach Inventory Burnout (MBI) duke patur parasysh tre komponentët.

Nga rezultatet u arrit në përfundimin se infermierët në Jordani raportojnë një nivel të lartë të tejlohdhjes emocionale (Mesatarja = 31.5 dhe Devijimi Standart = 12.84)

Sipas vlerës së koeficientit të korrelacionit kishte një marrëdhënie korrelacionale pozitive mes moshës ($r = 0.111$, $P \leq .05$) dhe burnoutit, që do të thotë se me kalimin e viteve rriten mundësitë që infermierët të preken nga burnout.

Të njëjtën marrëdhënie korrelacionale pozitive e kishte dhe me eksperiencën në punë ($r = 0.117$, $P \leq .05$)

Me aftësitë për të marre vendime rezultoi një marrëdhënie korrelacionale negative ($r = -0.110$, $P \leq .05$) që do të thotë se sa më i lartë të jetë niveli i burnoutit aq më e ulët është aftësi për vendimmarrje.

Infermierët të cilët raportuan një nivel më të lartë të burnoutit i përkisnin pavionit të urgjencës ($F = 3.77$, $P \leq .05$). Prandaj sipas analizës së regresionit raparti ku infermierët punojnë është një faktor kryesor në nivelin e burnoutit.

Për të vlerësuar incidencën e burnoutit tek infermierët në urgjencë gjatë vitit 2017 u krye një rishikim literature për studime që kanë përdorur pyetësorin MBI në tre dimensionet, tejlohdje me lartë emocionale, depersonalizim i lartë dhe arritje të ulëta personale.

Ky rishikim literature përshiu databazat Cinahl, Cochrane, Cuiden, Ibecs, Lilacs, PubMed, Proquest, Psycinfo, Scielo, dheScopus.

U gjetën 13 studime me shkallën e vlerësimit MBI me dy shkallët e depersonalizimit dhe rraskapitjes emocionale dhe 11 studime që kishin përdorur komponentin e tretë të nivelit të ulët të arritjeve personale.

Kampioni i infermierëve të përzgjedhur ishte 1566. Prevalenca e secilës nënshkallë ishte 31% (95% CI, 20–44) për rraskapitjen emocionale, 36% (95% CI, 23–51) për depersonalizimin, dhe 29% (95% CI, 15–44) për arritje personale. Si konkluzion u arrit që

prevalence e fenomenit të burnoutit tek infermierët në urgjencë ishte e lartë, rreth 30% e kampionit ishte e prekur, me të paktën 1 në tre shkallët e pyetësorit. [20]

Kushtet e punës dhe faktorët personale duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet profilet e rrezikut për infermierët në urgjencë.

Në një studim të realizuar në Zelandën e re ku u mor një kampion prej 654 infermierësh u identifikua se 64.2% e tyre raportuan nivele të larta burnouti.

2.4 Infermierët në repartin e pediatriisë

Infermierët në repartin e pediatriisë përballen shpesh me fëmijë të cilët janë shumë të sëmurë aq sa mund të ndërrojnë dhe jetë. Këto situata të vështira emocionale të cilat ndodhin në mënyrë të përsëritur me kalimin e kohës provokojnë te infermierët lodhje e duke i çuar deri në burnout. Nivelet e larta të burnoutit rritin gabimet mjeksore dhe minimizojnë kënaqësinë e pacientëve.

Sipas Aiken (2001) më shumë se 40% e infermierëve në pavionin e pediatriisë raportojnë nivelet më të larta të burnoutit. Sipas tij 1 në 5 infermierë në pediatrii synojnë të largohen nga puna brenda një periudhe një vjeçare. [21]

Në studimin e realizuar prej tij morën pjesë 503 infermierë në pavionin e pediatriisë. Në analizën multivariabël infermierët e rinj raportuan nivel më të lartë të burnoutit ($p = 0.04$) dhe rezultate të ulta të kënaqësisë ($p = 0.001$) krahasuar me infermierët e moshës 40 vjeçare ose më të vjetër në moshë.

Prandaj sipas tij është e rëndësishme të hartohen strategji të cilat të sigurojnë një klimë pozitive në ambjentin e punës, përmirësimi i kushteve për të rritur nivelin e kënaqësisë në punë dhe zhvillin profesional të tyre

Për të zbuluar faktorët që ndikojnë në nivelet e burnoutit, stresin në punë, ankthin, mbështetjen e perceptuar sociale u realizua një studim ku synimi i tij ishte të krahasonte ndryshimet mes dy grupeve mes infermierëve të pediatriisë që punojnë në reaminacion dhe pjesës tjetër.

Pjesë e këtij studimi ishin 121 infermierë ($n = 121$), në një spital në SHBA ku një pjesë e të cilëve ishte pjesë e kujdesit intensiv neonatal dhe pediatrik.

Rezultatet treguan se infermierët të cilët punonin në terapinë intensive raportonin nivele më të larta të burnout. Nëpërmjet një analize të hollësishme u zbulua se stresi në punë është një nga faktorët më të rëndësishëm të shfaqjes së burnout ndjekur nga ankthi, mungesa e përvojës, mbështetjes etj.

Megjithatë sipas këtij studimi edhe pse infermierët e terapisë intensive raportonin nivele më të larta të burnout ky është një problem për të gjithë infermierët e repartit të pediatriisë. [22]

Hulumtuesit sugjerojnë se ofrimi i mbështetjes në punë veçanërisht për infermierët me pak përvojë mund të reduktoj burnoutin.

Ka dhe disa studime që kanë marrë në vlerësim lidhjen midis hidhërimit, burnout dhe kënaqësisë në punë tek infermierët pediatrikë.

Ky studim u krye në vitin 2014 në SHBA dhe u përdorën pyetësorët “Të dhënat e përvojës së hidhërimit, (RGEI),” “Të dhënat e burnout sipas Maslach (MBI)” dhe, “Indeksi i kënaqësisë në punë (IWS). [23]

Rezultatet treguan se hidhërimi kishte korrelacione shumë të forta, pozitiv me burnout, negative më kënaqësinë në punë. Infermierët raportuan tejldhje shumë të lartë emocionale kur vdisnin pacientët e tyre dhe faj më të lartë kur pacientët vdisnin më të rinj.

Konkluzionet sugjerojnë një ndërveprim dinamik statistikor midis hidhërimit të infermierëve, burnout dhe kënaqësisë në punë, duke prezantuar një rrugë me qëllim që të largoheshin nga pavioni, institucioni ose dhe vetë profesioni.

Rekomandimet e këtij studimi ishte implementimi dhe vlerësimi i ndërhyrjeve të programve të hidhërimit dhe edukimit

Jacobs LM dhe hulumtues të tjerë (2013) realizuan disa studime për të identifikuar karakteristikat e burnout, prevalencën e raportuar, ashpërsinë dhe faktorët e rrezikut, për të arritur në një kuptim më të mirë të rrezikut të rraskapitjes emocionale, depersonalizimit dhe arritjeve të ulta. [24]

Në këto studime morën pjesë 1600 infermierë në pavionin e pediatrikë. 82% e infermierëve të përzgjedhur ishin femra. Kishte një larmishmëri përsa i përket moshës së infermierëve pasi ajo varionte nga 23-62 vjeç. Pjesa më e madhe prej tyre rreth 60% i përkisnin grupmoshës 23/30 vjeç.

Në total u realizuan 34 studime për një periudhë disa vjeçare në mënyrë që të identifikohet niveli i burnoutit te infermierët e pediatrikë.

Duke u bazuar te Maslach Burnout Inventory (MBI) u arritën rezultatet e mëposhtme:

- (i) rraskapitje emocionale, 31% (95% CI: 25–37%)
- (ii) depersonalizimi, 21% (95% CI: 11–33%)
- (iii) arritje të ulta personale, 39% (95% CI: 28-50%).

Një numër i konsiderueshëm i infermierëve pediatrikë u zbulua se kishin nivele mesatare të larta të rraskapitjes emocionale dhe depersonalizimit, dhe nivele të ulëta të arritjeve personale.

Prandaj, këta infermierë ose ishin duke përjetuar burnout ose ishin në rrezik të lartë për ta vuajtur atë në të ardhmen.

Këto rezultate mbështesin nevojën për studime të mëtejshme të faktorëve të rriskut për burnout te infermierët në repartin e pediatrikë.

Ato gjithashtu theksojnë rëndësinë e zhvillimit të ndërhyrjeve ose terapive për të ndihmuar në parandalimin ose zbutjen e simptomave të mësipërme, duke ndihmuar infermierët të përballen me mjedisin e vendit të punës dhe me situata që mund të çojnë në burnout.

Gjithashtu sugjerojnë se infermierët duhet të ndjekin programe trajnimi në punë, ku një pjesë e këtyre trajnimeve mund të ketë edhe thjesht qëlime relaksuese.

3. Metodologjia

3.1 Prezantimi i studimit

Qëllimi => Qëllimi i këtij studimi është të evidentohen perceptimet e personelit infermieror në lidhje me nivelet e përjetimit të burnoutit.

Objektivat

- Të identifikojmë faktorët që ndikojnë në nivelin e burnoutit që infermierët përjetojnë.
- Të ndërgjegjësojmë infermierët për pasojat negative të fenomenit të burnout.
- Të rekomandojmë forma të ndryshme të përballimit të burnoutit
- Të arrihet realizimi i studimit në kohën e përcaktuar.

Hipotezat

Hipoteza 1 => Sa më tepër simptoma të rraskapitjes emocionale të përjetojnë infermierët aq më pak arrijte personale do të kënë në punën e tyre.

Hipoteza 2 => Për shkak të lodhjes së madhe emocionale infermierët e spitalit përjetojnë një nivel më të lartë burnout se infermierët e qendrave shëndetësore

Tipi i studimit dhe periudha e studimit:

Ky studim është i llojit :

- *Ndër - seksional (transversal)*

Studimi është shtrirë në një periudhë tre – mujore duke filluar në muajin korrik dhe duke përfunduar në muajin shtator.

3.2 Kampioni dhe procedura e përzgjedhjes së tij

Ky studim u realizua në qytetin e Vlorës dhe u përzgjedh një kampion prej 53 infermierë.

Kushti i domosdoshëm që duhet të plotësonin infermierët për të qenë pjesë e këtij studimi ishte se ata duhet të punonin me pacientë fëmijë.

Prandaj u vendos që personeli infermieror të përzgjidhej në repartin e pediatriisë dhe në qendra shëndetsore.

Në repartin e pediatriisë morën pjesë 32 infermierë përkatësisht 60.4% dhe pjesa e ngelur 39.6% u përzgjedh në 9 qendra shëndetsore. Infermierët kishin vite të ndryshme eksperience në punë.

Përzgjedhja e infermierëve që morrën pjesë në këtë studim u bë në mënyrë rastësore.

Çdo infermier u qartësua në lidhje me qëllimin e studimit dhe se do të ruhej anonimati.

Në mënyrë që rezultatet të ishin të vlefshme instrumeti u plotësua në një ambient të qetë dukë shmangur çdo ngacmues të jashtëm.

3.3 Instrumenti

Për realizimin e këtij studimi u përdor një pyetësor Maslach Burnout Inventory (MBI)

Përpara se infermierët të plotësonin këtë pyetësor atyre u kërkua një informacion në lidhje me disa të dhëna socio- demografike.

Lloji i variablave

Statusi civil , institucioni => variabla nominale

Eksperienca në punë, niveli i edukimit=> variabla ordinale

➤ **Maslach Burnout Inventory (MBI)**

Përshkrimi - është një nga teknikat diagnostike më të përdorura për të përcaktuar nivelin e burnoutit. Qëllimi i tij është të identifikoj rastet e prekura nga ky fenomen. MBI eksploron tre komponentë të rëndësishëm që janë:

➤ **Rraskapitje emocionale**

Rraskapitja emocionale i referohet një gjëndjeje të dërrmuar emocionale.

17 pikë ose më pak: Nivel i ulët burnout

18 deri në 29 pikë : Nivel i moderuar burnout

Mbi 30 pikë : Nivel i lartë burnout

➤ **Depersonalizimi**

Depersonalizim do të thotë indiferencë e theksuar në rritje , një shkëputje ndaj njerëzve me të cilët punon.

Shkalla e vlerësimit - përmban 7 pyetje të cilat vlerësohen secila me një shkallë(nga kurrë në çdo ditë).

Pikëzimi

5pikë ose më pak: Nivel i ulët burnout

6 deri në 11 pikë : Nivel i moderuar burnout

Mbi 12 pikë : Nivel i lartë burnout

➤ ***Arritje personale***

Ky komponentë përfaqëson të ndjerët jo efektiv në punë i referohet një rënie të nivelit të aftësive dhe produktivitetit si dhe një rënie të ndjenjës së vetëefikasitetit .

Shkalla e vlerësimit - përmban 8 pyetje të cilat vlerësohen secila me një shkallë(nga kurrë në çdo ditë).

Pikëzimi

33 pikë ose më pak: Nivel i ulët burnout

34 deri në 39 pikë : Nivel i moderuar burnout

Mbi 40 pikë : Nivel i lartë burnout

Pikat e forta të instrumentit:

- Përdorim i gjerë i instrumentit për personelin e kujdesit shëndetsor
- Përdorimi në një numër të madh kulturash

Pikat e dobta të instrumentit:

- Nuk është i standartizuar në vendin tonë por është i standartizuar për kultura të tjera.

3.4 Analiza e të dhënave

Të dhënat që u mbledhën nga instrumentet e përdorura në këtë ministudim,u futën në një bazë të dhënash duke përdorur paketën statistikore SPSS 22.

Të dhënat u futën në bazën e të dhënave nga një person i vetëm.

Analiza e të dhënave konsistonte në një analizë deskriptive të realizuar nëpërmjet programit SPSS, duke llogaritur frekuencat, mesataret dhe përqindjet crosstabulimet.

Statistikat e përfshira në këtë program bazë janë korrelacionet dhe T-test

Siç është përmendur edhe më përpara , janë mbledhur dhe analizuar të dhënat ekzistuese, të cilat kanë qënë sasiore.

3.5 Limitet e studimit

Ky studim përmban një sërë kufizimesh:

Së pari, koha në të cilën u shtri ky studim ishte shumë e kufizuar, gjë që nuk na mundësoi ta zhvillonim studimin në një përfshirje më të gjerë gjeografike.

Së dyti, studimi nuk pati përfshirje të gjerë gjeografike, duke u kufizuar vetëm në qytetin e Vlorës çka pengon përgjithësimin e rezultateve

Së treti, numri i kampionit për këtë studim është relativisht i vogël çka nuk mund të lejojë përgjithësime për të gjithë popullatën..

Së katërti instrumenti nuk është i standartizuar në vendin tonë.

4. REZULTATET

Karakteristikat e përgjithshme të kampionit


Në këtë studim u përzgjedhën 53 infermierë në repartin e pediatriisë dhe në qendrat shëndetsore të qytetit të Vlorës.

Infermierët që u bënë pjesë e këtij kampioni kishin vite të ndryshme eksperience në punë.

	Frequenza	Percentuale
Valido Me pak se 5 vite	13	24,5
5-10 vite	10	18,9
10-15 vite	14	26,4
15-20 vite	7	13,2
Me teper se 20 vite	9	17,0
Totale	53	100,0

Tabela 1: Eksperienca në punë

Të dhënat e paraqitura në mënyrë grafike



Grafiku 1: Eksperienca në punë


Të dhënat e mësipërme na tregojnë se infermierët kanë vite të ndryshme pervoje në punë. 24.5% e tyre kanë më pak se 5 vite. Një pjesë e konsiderueshme e tyre 26.4%. Ndërkohë që pjesa më me eksperiencë e infermierëve mbi 20 vite pune përbën 17% të kampionit

Për infermierët e përzgjedhur u mor një informacion në lidhje me nivelin e tyre të edukimit

	Frequenza	Percentuale
Valido Arsim i larte universitar	32	60,4
Arsim pas universitar	21	39,6
Totale	53	100,0

Tabela 2: Niveli i edukimit

Rezultatet e paraqitura në mënyrë grafike



Grafiku 2: Niveli i edukimit


Përpunimi statistikor i të dhënave na tregon se 60.4% e infermierëve kanë arsim të lartë universitar dhe 39.6% arsim pasuniversitar

Duke marr parasysh tematikën që do të trajtojmë me rëndësi ishte të dinim statusin civil të infermierëve të përzgjedhur.

	Frequenza	Percentuale
Valido I/e martuar	30	56,6
Beqar	11	20,8
I/e divorcuar	7	13,2
I/e ve	5	9,4
Totale	53	100,0

Tabela 3: Statusi civil

Të dhënat e paraqitura në mënyrë grafike



Grafiku 3: Statusi civil


Rezultatet e mësipërme na japin informacion se 56.6% e infermierëve gëzojnë statusin e të martuarve, 20.8% të beqarve. 13.2% e infermierëve deklaruan se ishin të divorcuar dhe 9.4% të ve.

Duke qenë se kontakt me fëmijët nuk kanë vetëm infermierët në repartin e pediatriës u mendua që pjesë e këtij studimi të ishin dhe infermierët nga qendrat shëndetsore.

	Frequenza	Percentuale
Valido Spital	32	60,4
Qender shendetsore	21	39,6
Totale	53	100,0

Tabela 4: Institucioni i përzgjedhur

Të dhënat e paraqitura në mënyrë grafike



Grafiku4: Institucioni i përzgjedhur


Pjesa më e madhe e kampionit përbëhet nga infermierët që punojnë në spital përkatësisht 60.4% , kurse 39.6% punojnë në qendrat shëndetsore në qytetin e Vlorës.

Me interes ishte të njiheshim me arsyen që i kishte çuar infermierët të përzgjidhnin këtë profesion.

	Frequenza	Percentuale
Valido Profesion me te ardhura te larta financiare	27	50,9
U vjen ne ndihme njerezve ne nevoje	10	18,9
Zgjedhje rastesore	16	30,2
Totale	53	100,0

Tabela 5: Zgjedhja e profesionit

Të dhënat e paraqitura në mënyrë grafike



Grafiku 5: Zgjedhja e profesionit

Për pjesën më të madhe 50.9% ky profesion është parë si një profesion me të ardhura të larta financiare dhe prandaj e kanë zgjedhur. 30.2% janë shprehur se ka qenë thjesht një

zgjedhje rastësore dhe 18.9% e kanë konsideruar një profesion human që u vjen në ndihmë njerëzve .

Me interes është të shohim se cila ka qenë arsyeja që infermierët e spitalit dhe të qendrave shëndetsore kanë zgjedhur këtë profesion.

Tavola di contingenza Istituzioni ku punoni * Arsyeja pse e keni zgjedhur kete profesion

Conteggio

	Arsyeja pse e keni zgjedhur kete profesion			Totale	
